

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut dhe mos u përçani" (Ali-Imran 103)

# BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkoder  
Vitet I i botimit, Dhjetor 2007 Nr 8. Çmimi 20 lekë.  
www.gazetabesimtari.com; e-mail: info@gazetabesimtari.com  
Kryeredaktor Selim Gokaj



## EDI RAMA DHE QEVERIA DEMOKRATIKE KUNDER NDERTIMIT TE XHAMISE MUSLIMANËT NË TIRANË PO FALEN NE MES TË SHIUT



Rrëzimi i diktaturës ateiste në Shqipëri në vitet 90 u krijoi mundësi shqiptarve që të gëzonin edhe lirinë fetare e cila iu mohua për një periudhë, që llogaritet në dekada. Të gjithë menduam se tashmë lindi dielli i lirisë për të gjithë besimtarët, liri që duhet të ishte prone e të gjitha besimeve fetare në Shqipëri. Por, duket se për besimtarët muslimanë kalvari i mungesës së lirisë nuk kishte mbaruar, sepse, në emër të një integrimi në Evropë, që duket se është larg në një horizont të zymtë, po ushtrohet një dhunë e pandërprerë mediatike dhe administrative që tashmë bëhet haptas dhe pa doreza. Në këtë linjë padrejtësie, ndaj komunitetit më të madh fetar në Shqipëri, po pengohet ndërtimi i xhamisë në Tiranë e cila do të bënte që muslimanët të mos falen në rrugë në mes të shiut Historia e ndërtimit të kësaj xhamie daton në vitet 90, kur Partia Demokratike erdhi në pushtet. Në ato vite, presidenti, kryeministri dhe kryetari i bashkisë së Tiranës, i përkisnin Partisë Demokratike, duke i shtuar edhe kryeparlamentarin

..Por, edhe atëherë, kërkesa e KMSH, për të ndërtuar një xhami të madhe u hodh poshtë, anipse KMSH dispononte truadhin e saj dhe paratë e nevojshme dhe se ishin muslimanët ato që votuan thuajse në bllok për PD. Një drejtues i lartë i herarkisë që po qeveriste Shqipërinë në ato pat deklaruar: "Nuk lejojmë që të këndoje prifti, as hoxha tek dera e parlamentit". Të gjithë e kishin të qartë se nuk do të lejohej hoxha të këndonte tek dera e parlamentit, duke lënë të nënkuptohej se muslimanët nuk do të kishin xhami të madhe në Tiranë dhe se ata duhet të vazhdonin të faleshin në shi. Situata sot është edhe më e ashpër kundër kërkesës për xhami nga ana e muslimanëve në Tiranë, sepse sot Tirana ka një kryetar bashkie që e ka refuzuar me arrogancë ndërtimin e xhamisë në Tiranë dhe pa tjetër që është i lumtur që i sheh muslimanët e mjerë (se të mjerë janë deri sa pranojnë të poshtrohen nga një linjë qafire që po i shkel me këmbë në një hapësirë kohore që nuk ka të mbaruar), duke u falur në rrugë dhe në mes të shiut, një kryetar

bashkie që kurrë nuk i ka uruar muslimanët në festat fetare në mënyrë të qartë, por vazhdon të përdorë fraza të paqarta, sepse nuk i do as goja as zemra të urojë ata që po i dhunon duke abuzuar me ligjin. Sot, KMSH nuk po kërkon truadh, as nuk po kërkon privilegje nga pushteti qëndror dhe ai lokal, sepse KMSH ka truallin e vet dhe ka të drejtë të gëzojë një leje për të ndërtuar një xhami, ashtu si u ndërtua një katedrale shumë e madhe katolike, si u ndërtua një kabanë paqeje me gëzhoja lufte që nuk dihet në se bën thirrje për paqe, apo për luftë, kur lëshon tingullin e saj. Është kjo bashki dhe kjo qeveri që miratoi ndërtimin e një katedraleje ortodokse e cila nuk do të vonojë të lartësohet në hapësirën e urbane të kryeqytetit. Vetëm xhamia e muslimanëve nuk duhet të bëhet në asnjë mënyrë, anipse ato janë shumicë absolute në Tiranë. Dhe në se do të ndërtohet, ajo duhet të ndërtohet vetëm në periferi dhe mundësisht sa më e vogël, që kalvari i mundimeve për muslimanët të mos mbarojë kurrë dhe Shqipëria të ketë, së paku formalisht, një pamje të krishterë.

KMSH dhe kërkesa e tij për të ndërtuar xhaminë në Tiranë është vënë në pozicionin e topit të pingpongut, ku, dy lojtarët, Edi Rama dhe Sali Berisha, po ia kalojnë fajin njëri-tjetrit, në një kohe që është shumë e lexueshme se ata janë në një linjë për të mos dhënë leje për ndërtimin e kësaj xhamie, Ka shumë mundësi që ato duhet të jenë pjesë e asaj aleance që rri në hije dhe punon nga kjo hije për të ndërtuar një fasadë të krishterë për Shqipërinë me shpresën se do do bëhet e besueshme për kancelaritetë ndërkombëtare, të cilat nuk dihet se çfarë po "Gatujnë" për shqiptarët në "Guzhinat" e tyre, që historikisht kanë gatuar gjellë të helmatisura për popujt e pambrojtur si ne shqiptarët. Mendojë se KMSH duhet të jetë në pozita më të vendosura, më radikale, më militante në kërkesën e tij, sepse ka të drejtë ligjore dhe fetare. Duhet të punojë me xhematin e xhamiave në të gjithë vendin dhe të organizojë protesta paqësore para bashkisë dhe para kryeministrit, duke u kujtuar këtyre institucioneve se muslimanët shqiptarë gëzojnë të drejtat e tyre si besimtarët e religjioneve të tjera dhe se teoria që njëri është i ndjerkës, kurse tjetri i nënës, mund të sjellë pasoja të paparashikueshme për vetë ato qarqe, ose individë që notojnë në këto ujra.

Selim Gokaj Shkodër, me 25 nëntor 2007

**GAZETA UDHA ISLAME NE  
5-VJETORIN E BOTIMIT TE SAJ**  
Fq 2  
**CEREMONI ME RASTIN E  
5- VJETORIT TE GAZETES  
UDHA ISLAME**  
Fq 2

**AKADEMIKU REXHEP QOSJA  
PER FIGUREN E NENE TEREZES**  
Fq 3  
**NE SHKODER PERKUJTOHET  
RIHAPJA E XHAMISE SE PARE**  
Fq 4

**BESIMTARI QE LUTET DHE  
MENDON PER ALLAHUN**  
Fq 4  
**ISLAMI NË EPOKËN E  
GLOBALIZMIT**  
Fq 6

## GAZETA UDHA ISLAME NE PESEVJETORIN E BOTIMIT TE SAJ



Kur në Shkodër, Myftinia botoi gazetën Udha Islame me kryeredaktor, teologun Arben Halluni, i cili sapo kishte filluar punën pranë kësaj Myftinie, ato që e njihnin teologun Arben Halluni dhe përkushtimin e tij për të kontribuar edhe me media për fenë islame, nuk u habitën shumë, sepse ishte po ky besimtar i devotshëm i cili, që kur ishte i ri ishte përfshirë në lëvizjen e rinisë islame dhe kishte botuar gazetën e pare, Triumfi Islam, organ ky i Rinisë Islame Shkodër, Në atë kohë, gazeta që u botua në vitin 1993 duke shënuar një arritje të jashtzakonshme për mediat islame në Shqipëri, gazete që tashmë ka hyrë në arkivin e këtyre mediave. Por, gazeta Udha Islame do të ishte e një kapaciteti tjetër, sepse kjo po botohej nga një institucion i konsoliduar që mbulonte një hapësirë të madhe islame duke e obliguar këtë gazete në cilësi si: në paraqitje, ashtu edhe në trajtimin e probleme që kishin të bënin me mbrojtjen e interesave të fesë islame. Kanë kaluar pesë vite nga tetori i vitit 2002, kur doli në qarkullim gazeta Udha Islame dhe ne jemi dëshmitarë se kjo rruga ka qenë e suksesshme dhe ajo, me 60 numurat e saj, nën drejtimin e kryeredaktorit të saj, teologut Arben Halluni, i cili ka punuar në mënyrë vullnetarë për ta botuar dhe për ta konsoliduar këtë gazetë islame, e ka justifikuar botimin e saj duke qenë një tribune e vërtetë e mendimit islam.

Gazeta Udha Islame, në numurat e parë të saj, doli në qarkullim me 8 faqe duke ia lënë rrallën numurave të tjerë me 12 faqe, ku ngjyra do të kishte faqja e pare dhe ajo e dymbdhjetë. Nga numuri në numur, gazetes do t, i shtohet tirazhi dhe do t, i shtohet cilësia e saj, falë bashkëpunimit të shumë teologëve islamë dhe të shumë intelektualëve që mbulonin fusha të

ndryshme të jetës, të cilët duhen falenderuan për angazhimin dhe përpjekjet e tyre për ta bërë gazetën Udha Islame një nga mediat me të kërkuara edhe nga lexuesi jo musliman. Gazeta Udha Islame botoi kurdoherë shkrime aktuale, të cilët e bënë këtë gazete shumë të larmishme, sepse ajo tashmë trajtonte çështje fetare, edukative, kulturore, shkencore aktivite fetare, deklarata të Myftinisë dhe të shoqatave muslimane si edhe përgjigje nda shkrimeve që bënin mediat antiislame që sulmonin vlerat e fesë islame Gazeta Udha islame kishte edhe pika kulminante, kur ajo pranoi të botojë shkrime që mbronin figurën e ndritur të Profetit a. s, shkrime që merrnin nën mbrojtje popullin e Libanit, që po masakrohej nga ushtria izrailite dhe shkrime e deklarata që iu kundërvunë një klubi fantazëm të një gazetari që ka alergji për muslimanët, siç është Mentor Nazarko, ku u deklarua se muslimanët në Shqipëri po shkojnë, me këto ritmet të rënies në përqindje, drej minorancës. Duke evidentuar me të drejtë arritjet e gazetes Udha Islame, ne kujtomë punën e jashtzakonshme që ka bërë kryeredaktori i saj i palodhur, teologu Arben Halluni, për shpërndarjen dhe çuarjen e saj tek lexuesi, duke bërë që gazeta Udha Islame të gjendej në të gjitha pikat e shitjes, nëpër xhamia dhe në shumë ambjente të tjera muslimane, pa harruar se Gazeta Udha islame tashmë i kishte kaluar kufijtë shtetërorë, duke u gjendur edhe në Ulqin e Kosovë. Edhe në internet, po të këkoje, do të kishte fatin të gjeje dhe të lexoje Gazetën Udha islame, duke marrë kështu i nteresuari një materjal të rrallë për islamin. Sukses i madh për gazetën Udha Islame është se ajo nuk pati asnjëherë ndërprerje, as pauza aksidentale, falë

punës dhe angazhimit të pandërprerë dhe të kujdssshëm të kryeredaktorit të saj, teologut Arben Hallun i cili, botimin e kësaj gazete, e kishte bërë pjesë të rendësishme të punës dhe të jetës së tij, duke siguruar një botim të pandërprerë të saj Por, duhet vlerësuar edhe kontributi që dhanë tre drejtuesit e Myftinisë Shkodër në këtë hark kohor prej 5 vitesh si: H. Faik Hoxha, H. Bashkim Bajraktari dhe imam Ndiçim Sulejmani të cilët janë pa tjetër pjesë e suksesit të gazetes Udha Islame

Por, mendojmë se një ndër vlerat kryesore të gazetes Udha islame dhe e kryeredaktorit të saj, teologut Arben Halluni, është se ai nuk u krijoi hapësira replikave dhe debateve që çenojnë mendimim islam dhe fyejnë e nëpërkëmbin besimtarët muslimanë. , duke iu përmbajtur devizës islame se besimtarët muslimanë janë vëllezër dhe se të gjithë besimtarët muslimanë kanë një qëllim të vetëm i cili është mbrojtja e Fesë Islame dhe mos të bëjnë diversion kundër saj dhe besimtarve muslimanë

Flitet se Gazeta Udha Islame do të ketë së shpejti një kryeredaktor të ri i cili mendohet të jetë një teolog i fesë islame Ne na vjen keq që po largohet drejtuesi dhe themeluesi i gazetës Udha Islame, por jemi të bindur se ai po i lë pas drejtuesit të ardhshëm të gazetes një media të suksesshme, të cilën jemi të bindur se edhe kryeredaktori i ri do të vazhdojë ta çojë përpara atë që po lë pas drejtuesi paraardhës i tij dhe ajo që ka rendësi është se jemi të bindur që kryeredaktori i ri do ta çojë përpara këtë media të rendësishme islame e cla tashmë nuk i përket vetëm muslimanëve të qytetit të Shkodrës, por të gjithë hapësirave ku jetojnë muslimanë shqiptarë e më gjërë

**REDAKSIA E GAZETES BESIMTARI**

Në ambjentet e lokalit, "Restoran Hysa", u zhvillua ceremonia e pesëvjetorit të botimit të gazetës Udha Islame, organ i Myftinisë Shkodër. Ceremonia u drejtua nga n/drejtori i medrezesë Haxhi Sheh Shamia, dega e djemve, Artur Tagani, i cili e filloi ceremoninë duke i dhanë të drejtën e fjalës teologut Arben Halluni, kryeredaktori i gazetes Udha Islame dhe inspektor për çështjet e arsimit pranë Myftinisë Shkodër. Në fjalën e tij, teologu Arben Halluni bëri një paraqitje me kompetencë për rrugën e gazetes, që nga numuri i pare, deri tek numuri 60, duke theksua se gazeta Udha Islame ishte e hapur për shumë bashkëpunëtorë duke ruajtur vlerat islame të gazetes dhe duke i prerë rrugën tendencave për t, i thurur lavdi Unit, si tregues që nuk është në linjë me Islamin. Oratori theksoi se kjo gazete është një arritje për çështjen islame në Shkodër dhe në të gjithë

## CEREMONI ME RASTIN E 5- VJETORIT TE BOTIMIT TE GAZETES UDHA ISLAME

Shqipërinë. Udha islame është gazeta e vetme e një Myftinie në të gjithë Shqipërinë, tregues ky që i rrit vlerat kësaj gazete Pastaj e mori fjalën redaktuesi i gazetës Udha Islame, Eljaz Kraja i cili tha se është bërë një punë dhe kujdes i madh që gazeta të jetë shembull për zbatimin e rregullave të drejtshkrimit, i cili është një tregues cilësor për gazetën Udha islame. Kryeredaktori i ri i gazetës Udha Islame, Lavdrim Hamaj shpalosi para të pranishmëve platformën e ardhshme të gazetes Udha Islame, duke theksuar se gazeta tashmë do të ketë një format më të madh duke qenë në madhësi si gazetë të tjera. Ai theksoi se do ndërrojë edhe mënyra e faqesjes së gazetes dhe do të zgjerohet tematikën, duke rritur cilësinë e

gazetes në të gjithë treguesit e saj. Fjalën e mori Myftiu i Shkodrës, Imam Ndiçim Sulejmani, i cili vlerësoi në pesëvjetorin e gazetes, punën që ka bërë gazeta Udha Islame dhe kryeredaktori i saj, teologu Arben Halluni që ka dhënë një kontribut të veçantë në arritjet e gazetes. Në vazhdim të fjalës së tij, ai foli me besim për të ardhmen e gazetes Udha Islame nën drejtimin e kryeredaktorit të ri, Lavdrim Hamaj. Nga drejtuesi i ceremonisë iu dha fjala edhe të pranishmëve nga salla. Kryeredaktori i gazetes Besimtari dhe bashkëpunëtori i gazetes Udha, Islame, Selim Gokaj, Në fjalën e tij ai përshëndeti të pranishmit dhe tha se botimi i kësaj gazete ishte një arritje e madhe për Myftininë Shkodër dhe se gazeta

nga numuri në numur e ka rritur cilësinë dhe tematikën e saj, pa harruar edhe rritjen e numurit të bashkëpunëtorve. Ai theksoi se arritjet lidhen drejtpërsëdrejti me angazhimin dhe punën e kryeredaktorit të saj, teologut Arben Halluni i cili vazhdoi kontributin e tij për të zënë vend në hapësirën mediatike edhe media islame, pasi në vitet 90 kishte themeluar dhe botuar gazetën Triumfi Islam e cila ishte dallandshja që do të sillte më vonë gazetën Udha Islame. Ish- muftiu i Shkodrës, Haxhi Bashkim Bajraktari, pasi foli për arritjet e gazetes Udha Islame, ai u tregua i gatshëm që të bashkëpunojë me kryeredaktorin e ri të gazetes Udha Islame. Pas përfundimit të ceremonisë, të pranishmit u ftuan në një koktej duke i dhënë kështu fund një aktiviteti kreu të vaçantë në llojin e vet.

*Selim Gokaj  
Shkodër me 1 dhjetor 2007*

## AKADEMIKU REXHEP QOSJA PER FIGUREN E NENE TEREZES



Po cila është e vërteta për qëndrimin tim ndaj majtjes së portretit të Nënë Terezës në institucionet e Kosovës, që është një institucion partiak dhe shtetëror?

Nuk është e vërtetë që jam ngritur me "nervozizëm" kundër mbajtjes së portretit të shenjtore, Nënë Tereza në institucionet e Kosovës. E vërteta është se jam ngritur dhe ngrihem pa nervozizëm kundër përdorimit politik të emrit, të portretit dhe të veprimtarisë të misionares dhe humanistes, Nënë Tereza, prej disa fundamentalistëve fetarë dhe disa konjunkturistëve politike, gjithnjë për interesat e tyre fetare në rastin e pare dhe pushtetare në rastin e dytë Menjëherë pas vdekjes së saj, për këtë figurë fetare kam botuar një sprovë dhe kam dhënë dy deklarata, një të kërkuar nga BBC, tjetër nga mediat e Prishtinës. Qëndrimi im ndaj emrit dhe portretit të Nënë Terezës sot nuk mund të jetë i kushtëzuar nga përdorimi fundamentalist fetar dhe politik i atij emri dhe i atij portreti. Mbas gjithë asaj që është bërë dhe po bëhet rreth Nënë Terezës, do më thënë pas gjithë këtij përdorimi e shpërdorimi politik të emrit, të portretit dhe veprimtarisë së saj si misionare e humaniste, nuk e quaj kombtarisht të mençur mbajtjen e portreteve të saj, qoftë në institucionet politike të Kosovës, qoftë në institucionet e shtetërore të Shqipërisë londineze. JO. Është e tejtheksuar se veprimtaria prej humanisteje e Nënë Terezës është e pandarë, madje, e kushtëzuar nga veprimtaria e saj prej misionareje katolike. Papa Gjon Pali ka shpallur disa qindra të shenjtë, gjithsesi, thonë njohes të tij, më shumë se gjithë papët para tij. Ndër shenjtoret dhe shenjtoret që ka shpallur ai dhe që kanë shpallur papët para tij, natyrisht se nuk ka ortodoks, hebrenj, hindus muslimanë. Të gjithë janë shpallur shenjtore dhe shenjtore sepse ishin të jashtzakonshëm si katolikë. Është e kuptueshme se prej gjithë atyre që e shikojnë

portretin e Nënë Terezës, kudo qoftë i vënë ai, që e shikojnë shtatoren e saj kudo qoftë ngritur ajo, që e lexojnë emrin e saj kudo qoftë i shkruar ai, Nënë Teza përceptohet si shenjtore katolike.

Kot përpiqen të na mushim mendjen përdoruesit fetarë dhe politikë të emrit, portretit dhe veprimtarisë së saj humaniste, se Nënë Tereza meriton të jetë porteti, shtatorja mbishkrimi mbizotërue në institucionet politike dhe shtetërore, në institucionet kulturore shqiptare sepse është fituesja e vetme shqiptare e çmimit Nobel. Çmimi Nobel i është dhënë edhe shkencëtarit dhe humanistit shqiptar, Ferid Murati, zbulimi shkencor i të cilit është i rëndësishëm për të gjithë njerëzit, në të gjitha kontinentet e jo vetëm për të semurët e të varfërit e të braktisurit e botës, para së gjithash të Indisë. Por, Ferit Murati nuk i ngrihet kund një shtatore, nuk stoliset me emrin e tij ndonjë institucion kulturor, nuk vihet portreti i tij në ndonjë institucion politik e shtetëror. Përse? Sepse FERIT Murati nuk është katolik. Prandaj, emri dhe portreti i tij nuk mund të shpërdoren për nevojat e mobilizimit politik të krishtërimit dhe për nevojat karrieriste të konjunkturistëve tanë politikë dhe kulturorë. Në fund të shtjellimit të sipërthënë është e kuptueshme të shtrohet pyetja :Ku i çon shqiptarët përdorimi i tejshtirirë e i tej madhëruar fetarish i emrit, i portretit dhe i veprimtarisë së Nënë Terezës? A ka vlerë për shqiptarët përdorimi i kësaj figureje fetare të cilët i përkasin disa feve :katolikë, ortodoks, muslimanë, protestantë e të tjerë? Përdorimi aq irracional i emrit, i figures dhe veprimtarisë së një shenjtoreje sa edhe emri i aeroportit të Tiranës pagëzohet me emrin e saj:Nëna Tereze, edhe pse çdokush mund ta dijë se prej atij aeroporti, ashtu si edhe çdo aeroporti në këtë botë, mund të ngrihen nesër edhe aeroplanë luftarakë, që do të bombardonin fshatra dhe qytete e të vrasin burra, gra, fëmijë, të varfër dhe të sëmurë, të cilëve ajo u kishte kushtuar jetën.

Ç, farë do të thotë ky mitologjizim, në thelb fetar, për arsye fundamentaliste fetare dhe të konjunkturshme politike, i një shenjtoreje në një vend shumë, fetar?

Logjika e jep këtë përgjigje:Do të thotë nxitje e pjesëtarve të feve të tjera, parasëgjithash, të fesë muslimane, që e njëjta gjë të bëhet me emrat dhe me portretet e shquara fetare të fesë islame. Për këtë arsye emri, portreti dhe shtatorja e Nënë Terezës duhen vënë në mjedise fetare, humanitare dhe shëndetësore e jo edhe në Aeroportin e Tiranës, e jo edhe në institucione politike dhe shtetërore, e jo edhe në sheshet e qyteteve.

Përgaditi H. Vehbi Dani Shkodër me, 26 nëntor 2007

Kryetar i Shoqatës Bamirëse Shkodër

## NE PRAG TE VDEKJES TITOJA HEDH POSHTE ATEIZMIN

Në vitin 1980 ishim të ftuar në Beograd me ftesë të presidentit të Jugosllavisë, Marshall Titos (.SalihGokkaya i cili ka harxhuar 50 vjet në shërbim të ideologjisë komuniste dhe në vitet e fundit të jetës së tij u bë musliman. Ai ishte i ftuar nderi i Ttos).

Rreth shtratit të liderit komunist , i cili kishte harxhuar 70 vjet nga jeta e tij 83 vjeçare në shërbim të komunizmit dhe të Jugosllavisë, shkonin e vinin shërbëtorë që plotësonin dëshirat e fundit të tij..Tito nuk ishte i zoti të fliste si më pare, kur u drejtohej miliona njerëzve. Tashmë funksioni i duarve dhe këmbëve të tij ishte dobësuar shumë,sytë i ishin mbushur me lot, buzët i dridheshin dhe fëtyra kishte marrë një pamje dhimshurie.Kur e kuptova gjendjen e tij desha t,i them diçka për ta qetësuar.Zotëri ! Nuk duhet të trembeni nga vdekja. Ndoshta me trup po largohesh nga kjo jetë, por shpërtërisht ,me veprat, e tua do të jeshë i gjallë në zemrat e njerëzve.Kur ndigjoi fjalën vdekje, e pamë të dridhet sikur ta kishte zënë termeti . Fjalët që tha në ato momente më buçasin në vesh edhe tani .Po. Unë tashmë po vdes .Edhe po t,ua shpjegoi ju, që jeni të shëndetshëm ,nuk mund ta kuptoni dot në këtë moshë:Të ndahesh nga shokët , miqtë , nga posti dhe nga pozita , të bëjnë të çmendesh. Shokë! Do t,u tregoi diçka me zemër të hapur . Në qoftë se, pasi të vdes ,do të bëhem dhe , në qoftë se nuk ka ringjallje , shpërblim dhe ndëshkim , cila është vlere e pëpjekjeve të jetës sime ?

Më thoni ? Në qoftë se unë do të ndëshkohem deri në pafundësi, ç,fare vlere ka të jetoj në zemrat e të tjerëve dhe të duartrokitem? Pasi të vdes, unë a do të arrij zhurma e duartrokitjeve që bëhen për mua ,të ndalojnë gjarpërinjtë dhe krimbat , të mos e hanë kufomen time? Më thoni se ku të çon rruga që kam nisur unë tani? Marks ,Engelsi dhe Lenini nuk i japin dot shpjegim kësaj .Jam i detyruar ta pranoi se unë i besoi Zotit, Botës së `Përtejme.Ateizmi nuk është rrugëzgjidhje . Mendoni pak .Kjo gjithësi ka nevojë për një krijues Ky sistem i mrekullueshëm ka nevojë për një ligjëvënës .Për mendmin tim, vdekja nuk mund të jetë një fund.Duhet të ketë një vend drejtësie për ao që kanë vuajtur në këtë botë .dhe për ato që i kanë bërë të vuajnë. Të gjithë vdesin pa u shpërblyer , ose pa u dënuar për atë që kanë bërë në jetë.Kjo gjë nuk duhet të jetë kaq e lehtë( J. B.Tito i penduar)

Ky material është marrë nga f. 105 e

librit"Njeriu që kërkon vetveten"me autor Halit Ertugrul.

Përgaditi Vehbi Hoti

# NE SHKODER PERKUJTOHET RIHAPJA E XHAMISE SE PARE PAS RENIES SE DIKTATURES KOMUNISTE

Myftinia Shkodër ka organizuar, me datën 16 nëntor 2007 ,një ceremoni në xhaminë e Plumbit për të përkujtuar ditën e rihapjes së xhamisë së pare në Shqipëri pas rënies së diktaturës komuniste e cila është edhe dita e pare e rihapjes së fesë slame në Shqipëri.

Në këtë ceremoni merrte pjesë myftiu i Shkodrës, imam Ndriçim Sulejmani dhe anëtarë të tjerë të stafit drejtues të kësaj myftinie. Ishin të ftuar edhe nismëtarë të këtij akti historik për fenë islame ,. nxënës të medrezeve të Shkodrës dhe besimtarë të shumtë muslimanë.Ceremonia filloi me fjalën e hapjes nga teologu Arben Halluni dhe më pas

Haxhi Shukri Kapllani këndoi disa versete kuranore. Mbi rendësinë e kësaj ngjarjeje kaq madhështore për muslimanët në Shqipëri, foli një nga nismëtarët kryesorë të kësaj ngjarjeje, Mithat Myftia ,i cili solli para të pranishëmve momentet më të rendësishme të asaj ditë dhe kujtoi ata që ishin të parët që iu kundërvunë dktaturës dhe hapen xhaminë e Plumbit që është edhe xhamia e pare që u hap në Shqipëri ,duke shënuar kështu ditën e pare të hapjes së fesë islame në Shqipëri.

Pas këtij momenti, u mbajt edhe një hatme. Faljen e xhumasë e drejtoi myftiu i Shkodrës ,imam Ndriçim Sulejmani, cili gjatë faljes dha vlerësime të larta për datën 16 nëntor që tashmë është kthyer në një date historike shumë të rendësishme për të gjithë popullin shqiptar.Në



stacionin televiziv lokal, Shkodra TV Chenell, Myftinia Shkodër organizoi, me rastin e kësaj ngjarjeje historike , një emision special të përgaditur dhe të drejtuar nga teologu Arben Halluni. Të ftuar në këtë emision special ishin: ish- myftiu i Shkodrës,

H.Faik Hoxha dhe Xhelal Sokoli ,një nga themeluesit kryesorë të KMSH në Shqipëri. Gjithashtu ishin të ftuar nismëtarë të hapjes së fesë islame në Shqipëri si:Mithat Myftia,

dhe Pëllumb Sallko.

Ky emision special ka zgjatur thuajse dy orë dhe është ndjekur me interes nga teleshuesit, të cilët paten rastin të shikojnë dhe të ndigjojnë momente të rendësishme , emocione dhe nostalgji që nuk mund të harrohen kurrë, sepse ajo ngjarje tregoi se fjala e Allahut të Madhërueshëm mund të pengohet përkohësisht, por nuk mund të ndalohej nga askush

**REDAKSIA E GAZETES BESIMTARI**

## BESIMTARI QE LUTET DHE MENDON PER ALLAHUN



Njeriut që vjen dhe shkon nga kjo botë, Allahu i ka dhënë aftësinë për të menduar dhe permes këtij mendimim ai i ka dhënë krahë progresit, i ka dhënë krahë madhështisë së tij si krijesa më e përkryer e Allahut. Të drejtën për të menduar e ka edhe besimtari musliman i cili, ndryshe nga mosbesimtari, mendon për egzistencën e Allahut të Madhnueshëm, për argumentet që vertetojnë dhe na bindin për të vërtetën e egzistencës së Allahut.

Këtë dhuratë për të menduar për Allahun e Madhnueshëm e kanë ata besimtarë që falin namazin

rregullisht të cilët në shtëpitë e tyre kanë një vend të caktuar ku kanë vendosur një saxhade ku kanë vendosur një stol të vogël që u mundëson këtyre besimtarve që të lexojnë Kur-anin Famëlartë. Është pikërisht ky vend i çantë të besimtarit rri në orët e vona të natës për të bërë realitet atë që na udhëzon Kur-ani Famëlartë në suret e tij kur na kujton:"Dhe faluni për hir të Tij në një kohë të nates, mandej adhurojeni Atë edhe natën mëgjatë" Besimtari musliman falet natën vonë edhe në një gjysmë errësirë, nën dritën e një qiri, duke krijuar rreth

vehtes një botëtë madhnueshme shpirtërore të cilën ia jep vetë lidhja e tij shpirtërore me Allahun e Madhnueshëm..

Pasi ka falur namazin, besimtari ulet dhe mendon duke pasë pranë edhe Kur-anin e Madhnueshëm. Ai mendon për madhësinë e Allahut, për mirësitë që Ai i ka dhënë njeriut. Mendon për madhësinë e natyrës që e rrethon besimtarin, për forcën e saj marramendëse, por që është nën urdhërat e Allahut, sepse Ai e ka krijuar dhe Ai e ka këtë natyrë gjigande nën kontroll. Dhe besimtari i mire mendon për një madhësi më të madhe se madhështia e natyrës. Dhe ajo është madhështia e Allahut, ndaj së cilës besimtari ka frikë e cila është frika ndaj Allahut Kjo e bën besimrain të afrohet edhe më shume me Allahun dhe të kërkojë gjithmonë mbrojtjen e tij, të kërkojë gjithmonë mirësitë e tij. Pranë saxhades, ku besimtari fal namazin, ai mendon edhe për sprovat në të cilat e ka vënë Allahu dhe sa ka qenë i gatshëm ai t, i kalojë ato. Mendon sa here është lutur për Allahun e madhnueshëm. Në mendje i vjen një histori e treguar nga një mik i tij, i cili, kur ishte femijë në fshat kulloste në mal bagëtitë dhe një ditë i kishte humbur ato Me lot në sy i ishte lutur Allahut të Madhnueshëm ta ndihmonte. Pas pak, tufa e bagëtitë u duk në anë të malit. Besimtari ka familje, ka gruan dhe miqtë e tij besimtarë për të cilët lutet para Allahut të Madhnueshëm që t, i marrë nën mbrojtje t, i mëshirojë dhe t, i udhëzojë në rrugën e besimit, në rrugën e shpëtimit për të siguruar Xhenetin. Pasi ka menduar dhe është lutur për Allahun e Madhnueshëm, besimtari pushon pak pranë saxhades ku fal namazin dhe, meqë koha ka ecur shumë, ai përgaditet të falë namazin e sabahut dhe të bëhet pastaj gati për të filluar ditën e re e cila, për besimtarin musliman, është një ditë ku ai bën përpjekje të largohet nga gjynahet dhe të jetë sa më pranë urdhërave të Allahut të madhërueshëm

**Kasem Zylja Shkodër me 17 nëntor 2007**

# Yje shqiptare ne qiellin islam

Fise dhe popuj Allahu i bani  
Që sejcilit t,i njihet tabani.  
Por ma afër te Allahu janë  
Ata që përsos e kanë takvanë.  
Ejani me mua se n,rrugë jam  
Me yjet shqiptar n, qiellin Islam.  
N,qiellin Islam shumë yje t,Shqipnis  
Hoxhë Tahsi i çamerisë.  
Në Stamboll emri i ka dale  
Themeloi fakultetin e pare.  
E nga Frashëri Shamsudin  
Për Sami shqiptar e dijnë.  
Vepra e tij Enciklopedia  
Me te mburret sot Turqia.  
E kah vona Hoxhë Albani  
Ai ishte djali shkodrani  
Për hadhihe i ka dal nami.  
Atje n, Sham e kudo shkon  
Emri i tij me nder takon.  
E si nur Hoxhë Gavoçi  
Për mirësi pak ju pa shoqi  
Shum talebe ai ka mësu  
Deri në SHBA i kam taku.  
Shkodrën e vet kurr se harroi  
Me shum mall shpesh here shkoi  
Me u knaq e me ndihmu  
Dorën e ndihmës duke afrue.  
E gjat luftës në Kosovë  
Alimi fisnik mori hov  
Pleqnia e thellë se ndaloi  
Fushës s,betejës pranë i shkoi.  
Asnjëherë s,iu ndal turri  
Me ç,ka ka lufton burri.  
Abdyl Kadri fort me nam  
Arnauti njihet n,Sham.  
Atje n,Pej rranjët i ka  
Disa here pat shku me pa.  
Edhe Shqipnin e vizitoi  
Një herë n,Shkodër ligjëroi.  
Arnaut edhe Shuajpi  
Në Vukatan i zu fill thalbi.  
Në Vukatan, Shkodër Loce  
Për burri ka pak shoqe.  
Mehmet Akif vjershetar  
Turqisë i dhuroi Hymn Kombëtar.  
Vjersha të tjera plot nur  
Për Islamin lavdi ai thur.  
Por Islami lavdata s,kërkon  
Zemra e poetit këndon.  
I krijon me shpirt e mall

Zoti i madh ia baftë hallall.  
Historian Husein Muenisi  
Atlasin Islam e qendisi.  
Për këtë vepër asht i pari  
Kështu nderon vehten shqiptari.  
N,Misir ai lind e rrit  
Origjinës i dha dritë.  
Imam Vehbiu në Amerikë  
Emër të mirë atje ka ba  
Shtat dekada në kurbet  
Kurr s,harroi vendin e vet.  
Pak në Lindje ,shumë n,Perëndim  
Fesë, Atdheut, gjithmon n, shërbim.  
Gjithmon Shkodrën e kujtoi  
Disa here atje shkoi  
Se atje burri mori kivetin  
Për të ba ball kurbetin.  
Forca durimin ka n,iman  
Që përfshin edhe iman.  
Lus Allahun ta nderoj  
Edhe mua shumë më ndihmoj.  
Penda e tij krijoi shumë shkrime  
Ja lam Allahut për shpërblime.  
Këta burra paçin rahmet  
Allahu i pranoftë në xhenet.  
Vepra e tyre asht madhështore  
S, kanë nevojë për permendore.  
S,kan nevojë për bronx e gur  
Vepra e tyre ndrit si nur.  
Shpërblim ,baltë nuk pranojnë  
Rizan e Allahut veç kërkajn.  
Mermeri e bronci dobi nuk ban  
Për Allahun mirësia kurban.  
Vetë vepra asht kallxues  
Fshati që duket s,do kallaus.  
Shoku-shokut borxh ia kemi  
Për njëri tjetrin gjithmon t jem.  
Për Allah të gjith punuan  
Din ,At, Atdhe fort nderuan.  
Dëshirë kam t,i kujtoi  
Me niet t, mir unë vjershoj.  
Kënd te Allahu s,rrekomandoj  
N, borxh t, Allahut për Atë mendoj.  
Prej tij merhamet kërkoi sa t,rroj  
Këto vargje i shkroi Burhani  
Një cop plis nga Vatani  
Jabanxhi, Jetim Zamani

**Burhan Fili**

## Shkaterrimi i botes asht afru dhe shenjat e kiametit mundet me u lexu

Kiameti gati asht, ai shumë asht afru  
Shenjat e tij për çdo gja janë vertetu.  
I dashuri Pejgamer ka tregu  
Për shumë shenja ai Resul ka lajmëru.  
Ashtu si ka lajmëru ai Resulillah  
Shenjat me sy kudo janë duke u pa.  
Gratë nuk kanë turp, janë zbulu në gjithë dynjanë  
Burrat pa besë janë ba, ma keq se grate.  
Janë pa seder, nuk u ka mbet burrëri  
Ato në shtëpi, nuk i pyet njeri.  
Fëmij nuk pyesin dhe janë ba si t,hutum  
Kanë lane fenë e Zotit, prandaj e kanë pësu.  
Zoti i madhnueshëm burrat i ka urdhru  
Mësoni grate e fëmijët që t,besojn mu.  
N,qoftë se nuk do t,i bëni fëmijët të më falen mu  
Do t,i bëj fëmijët të mos u binden ju.  
Sot kjo gjë kudo është vërtetu vertetu  
Fëmijët po sillen keq me prindërit duke i mundu.  
Njerëzit jan ba pa mëshir si t,tërbum  
I ka tërbu dyrnjaja vdekjen e kan harru.  
Ka dal Dexhali po sundon dyrnjan  
Mjer gjyhnaqari se besimtarit nuk ka çfar i ban.  
Dexhal janë njerëzit që zotin nuk besojnë  
Nuk kanë moral, njerëzit i mashtrojnë.  
Njerëzve u thonë jemi zoti juaj  
Përçajnë njerëzit, mos t,jen t, bashkum.  
Mjer i keqi, që nuk ka iman  
Se i miri dexhalin e kundërshton  
Zoti im është Allahu që më krijoi  
Ti je mashtruesi që Pejgameri na tregoi.  
Sot asht zor me ruj besimin për at që beson  
Dielli shpejt ka me lind andej nga perëndon.  
Kur të lindi dielli atje ku perëndon  
Zoti pendimin atëherë nuk e pranon.  
Hazreti Isaja n,tok do t,vij  
Dexhalizmi do ,t shkatërrohet prej tij.  
I zhduk dexhalët për ata nuk ka mëshirë  
Vendos ligjin e zotit n,tok kur t, vij  
Disa dit n,tok ka me ndej  
Njerëzit n, qetësi kan me qenë  
Masandej një kafshë prej toke ka me dal  
Ka për t,u fol njerëzve, përse nuk jan fal.  
Zoti ma në fund ka për të urdhëru  
Nga ana e Jemenit një erë ka për t,dergu.  
Kan me vdek gjith njerëzit që kan besim  
Ata që nuk kan fe derin.fund do t, rrin  
Gjithshka që Zoti n, kët bot ka kriju  
Kiameti ka m,u ba ka me i shkatërriu.  
Yjet një nga një n, tok kan me ra  
Njerëzit e pafe me sy kan me i pa.  
Qielli e toka kanë me u shkatërriu  
Uji i detit ka për të shterru.  
Gjithë planetet copa copa kan me ra  
Fushë e male rrafsh kan me u ba.  
Ka me u zhduk çdo gja që ka jetu  
S,ka me mbet i gjall askush veç Perendisë.  
Rrin shkatërriu dynjaja pa asken të gjall  
Dyzet vjet ka për të ndejur n,kët hall.  
E kujt asht pasunia Zoti thotë?  
E imja është përgjigjet vetë e thotë.  
Kush të dojë Kiametin mos ta shohë  
Të pendohet si thotë Kur-ani t,veprojë.  
Kushtë dojë që të mirat t,mos i humbin atij  
Mos t,i thotë njeriut Zot ,ose zotëri.  
Mos të thotë i zoti ,ose ka zotësi  
Zoti është një e nuk ka veç tij.  
Kush i përdor këto fjalë duhet ta di  
Ka bërë shirk, gjynah t,madh ka ai njeri.  
Ai njeri që Zotit e vë shok me gojë  
Zoti namazin atij nuk do t,ja pranojë.  
Të gjithë sa jeni ju muslimanë  
Bashkohuni rreth Kur-anit të gjeni derman.  
Ngado që t,jeni o muslimanë  
Ejani në rrugën e zotit t,gjeni derman.  
Vetëm feja islame ju ju bashkon  
Rrugët tjera vetëm ju përçajnë.  
Kush do që n,dy botët të shpëtojë  
Të ndjekë porositë e Profetit dhe selam t,i çojë

**Poezi Popullore**

## HARMONI DHE JO PER PERÇARJE

Binduni ju o, shqiptarë  
Veç Krijuesi nuk gabon  
Shumë dhunti ai na ka falë  
Gabon ai që i përçmon

Zoti i Madh dhe i vërtetë  
S,pyeti kënd kur na krijoi  
I Gjithfuqishmi pat merhamet  
Mbi gjithshka njeriun vlerësoi

Rrisk i madh asht me i kuptue  
Të gjithë favoret që na dha  
Shumë Kur-anin me vlersue  
Na meson çfar nuk dijm na

Si Kur-ani, si Hadithet  
Teologji t,mirfillt trajtojnë  
Por, dhe një gja dihet  
Shkencën ata s, përjashtojn

Ndaj Islami ka avantazhe  
Për të cilat kemi nevojë  
Harmoni dhe jo përçarje  
N,se njerëzimi don të rrojë

**Vehbi H. Hoti**

**Shkodër ,me 9 shtator 2007**



# Islami në epokën e globalizmit

Nexhat Ibrahim



*"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtonie nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqtë, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntitë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së Xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur."* (Ali Imran, 103)

Feja Islame është treguar dhe dëshmuar, në rrafshin teorik por edhe në atë jetësor, praktik, si mësim konstruktiv, efikas dhe fleksibil për çdo kohë dhe vend, i aplikueshëm në jetën e individit por dhe të bashkësisë. Nëse nuk do të kuptohej ky segment i Islamit, do të thotë, fleksibiliteti dhe gjallëria e mësimin islam, nuk do të mund të kuptoheshin as fenomenet që do të përmenden në vijim.

Si është e mundur që një njeri i tërhequr nga jeta publike dhe politike, i urtë dhe i butë nga karakteri, i cili për 40 vite nuk u shqua duke u përzier në politikën dhe fenë e vendit të tij, përnjëherë të shndërrohet në reformator fetar, politik, ekonomik dhe shtetëror?

Si është e mundur që ky njeri, deri atëherë me profesion bariu e pastaj tregtari, pa ndihmën e stacioneve radiotelevizive, pa shtyp dhe internet, të arrijë t'i bashkojë banorët e shkapërderdhur dhe militantë të shkretëtirës së Arabisë.

Si arriti po ky njeri, Muhammedi a.s., që një popull me frymë luftarake, pa kulturë të mjaftueshme dhe vazhdimisht i ngatërruar në luftra reciproke fisnore, ta mbledh nën një flamur, nën një ligj, nën një religjon, një kulturë, një qytetërim dhe nën një mënyrë të administrimit?

Dhe, në fund, si kjo që nën udhëheqjen e Muhammedit a.s. dhe me ndikimin e gjithanshëm të Kur'anit, njerëzit më të shfrenuar, të Arabisë, të bëhen shembull të moralit, të bindjes dhe dëgjueshmërisë ndaj

Zotit dhe bindjes ndaj ligjit dhe rendit qytetar?

Është e gjithënjohur, edhe nga muslimanët edhe nga jomuslimanët, se diç të tillë Muhammedi a.s. nuk e arriti me shkopin magjik, me ndihmën e fallxhinjve apo me dhunë e mashtrim. Kur Islami i përvetësoi shpirtat, zemrat dhe mendimet e njerëzve dhe kur pasardhësit e tij u njohën me epërsitë e Islamit kundrejt xhahilijetit (injurancës), po këta njerëz me vullnet të lirë, në rrugën e Zotit, e sakrifkuan çdo gjë që posedonin. Është interesant me këtë rast të ceket fjalimi mjaft ilustrues i Xhafer Ibn Talibit, të cilin ai e mbajti në pallatin e mbretit etiopian Negusit:

*"O mbret! Ne qemë njerëz pa dije, të dhënë pas idhujtarisë. Kemi ngrënë madje mishin e shtazëve të ngordhura dhe kemi bërë edhe shumë gjera të tjera të shëmtuara. Nuk i kemi respektuar obligimet tona ndaj kushërinjve dhe kemi vepruar keq ndaj fqinjve. Të fortit tonë kanë jetuar në llogari të të dobtëve, deri sa Zoti nuk e dërgoi Pejgamberin të na përmirësojë. Ai na ftoi në shërbim të Zotit dhe na ka tërhequr vërejtjen që ta braktisim adhurimin e idhujve dhe gurëve. Ai na ka ndaluar çdo gjë që është irtuese: rrenën, shpërdorimin dhe shpifjen. Për këtë arsye atij i kemi besuar dhe kemi filluar ta ndjekim dhe të veprojmë sipas mësimin të tij."*

Krahas domethënies historike, ky fjalim inspirohet dhe ilustrues i Xhaferit në atë kohë, për ne ka edhe domethënie vendimtare për kohën në të cilën jetojmë. Mos vallë Islami porosinë e tij reformatore, morale dhe qytetëruese e ka konsumuar në tërësi gjatë të kaluarës? Mos vallë njerëzia në shekullin XXI është në shkallë më të lartë morale dhe shpirtërore nga shkalla e shoqërisë së theksuar injorante (xhahiliste) dhe politeiste (mushrike)? Përgjigjja në të dy pyetjet është mohuese. Jo, shekulli XXI nuk mund të lavdërohet me gjendjen besimore, morale, politike, ekonomike dhe kulturore. Madje, gjendja nga vetë perëndimorët përshkruhet si më e rënda në ekzistencën e vet.

Mirëpo, ne do t'i shtrojmë disa ilustrime të qarta

të cilat flasin për natyrën përshtatëse të Islamit, për vitalitetin dhe fleksibilitetin e Islamit për t'iu përgjigjur sfidave aktuale, nga një anë, dhe për barbarizmin tmerrues dhe shkatërrues të njeriut bashkëkohor, modernizmit dhe pasmodernizmit, nga ana tjetër.

Disa milionë muslimanë jetojnë në ShBA, disa milionë në Gjermani, Angli, Francë e Itali etj. Numri i përgjithshëm i muslimanëve në botë, sipas burimeve perëndimore, e tejkalon numrin prej një miliardë e gjysmë. Muslimanët janë populli me rritjen më të shpejtë. Xhamitë dhe mesxhidet për çdo ditë po ndërtohen përgjatë tërë botës, prej Lindjes në Perëndim, prej Veriut në Jug. Në Kordobë, të njohur me vlerat islame të muslimanëve emevit në Spanjë, muslimanët spanjollë para pak kohësh e themeluan Universitetin Ndërkombëtar Islam "Averroes". Jo larg xhamisë së jashtëzakonshme të vjetër në Kordobë, muezini sërish thërret në namaz. Kjo ndodh pesë shekuj pas faktit të njohur kur edhe muslimani i fundit me mënyrat më turpëruese që dëbuar nga trolli spanjoll.

Por, ja edhe disa tregues të theqafes, të degjenerimit të qytetërimin modern.

Është bërë dukuri e zakonshme që në kontejnerë apo vende të tjera publike të gjenden bebe të posalindura të braktisura. Është bërë legjitime që edhe shumë foshnje nga marrëdhëniet jashtëmartesore të hedhen. Marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore, legalizimi i martesave të një gjinie dhe një varg i prostitucionit të organizuar fëmijëror, pandalshëm po shkretëron qytetet dhe vendet e tëra. Varshmëria e njerëzisë nga drogat e ndryshme por edhe nga risitë teknologjike aktualisht arrijnë nivele alarmante. Kemi edhe trafikimin me njerëz apo me pjesë të trupit të tyre, abuzimin me femra dhe pabarazinë e madhe sociale.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto devijime besimore, morale dhe shoqërore, nuk duhet hequr nga mendja se e ardhmja i takon Islamit. Islami mund të ndihmojë që njeriu moralisht i rrëzuar (esfelu's-safilin) të ngritet dhe të bëhet njeriu më i përkryer (ahsenu't-takvim). Para muslimanëve qëndron një ndërmarrje e madhe, e urtë dhe intelektuale. Ata nuk do të duhej të përpiqeshin t'ia adaptojnë mësimin islam kërkesave moderne por do të duhej ta gjallërojnë mësimin e Islamit në atë mënyrë çfarë do të mundësojë që Islami të njihet dhe të pranohet mjaftueshmëria e tij për epokën moderne.

Bukuria e këtij angazhimi qëndron në atë që Islami do t'i shpërbejë paqes dhe do të rrisë shansin që ai të bëhet feja numër një në botë në kohën që vjen. Shqiptarët muslimanë kanë edhe një epërsi: në kopshtin me disa fe e besime mund ta prezantojnë mësimin e tyre si më të mirin dhe më origjinalin në mënyrë mjaft të përshtatshme dhe në mënyrë shkencore. Këtë muslimanët e kanë bërë gjatë shekujve VII-XII, këtë mund të bëjnë edhe tash.

*"Secili (popull) ka një anë, të cilës ai i kthehet, ju shpejtoni kah punët e mbara, kudo që të jeni All-llahu ka për t'ju tubuar të gjithëve. All-llahu ka fuqi për çdo send."* (El-Bekare, 148.).

**Burimet:**

- [http://www.znaci.com/osnovi\\_vjerovanja/osnovi/art284\\_0.html](http://www.znaci.com/osnovi_vjerovanja/osnovi/art284_0.html)  
- Nexhat S. Ibrahim, Muslimanët në kërkim të Islamit, Shkup, Logos-A. (shih dy shkrimet: Kthimi i muslimanëve në Perëndim dhe Natyra, manifestimet, problemet dhe perspektiva e zgjimit të islamit në Ballkan.

## PERSE MEDIAT SHQIPTARE KANE NJE LINJE ANTIMUSLIMANE

Tashmë është bërë normë që, së paku, një media vizive ose e shkruar të çënojë interesat e muslimanëve, identitetin e tyre dhe ajo që është më shqetësuese, të çënojë edhe fenë e muslimanëve. Duket se rrallën e kishte Radio Tirana e cila, në emisionin e përditshëm, Enciklopedia e Radios, duke komentuar ngjarje dhe data të rëndësishme nga historia shqiptare dhe ajo botërore me datën 16 nëntor 2007. , pasi foli për data historike që kanë shumë pak rëndësi për ndigjuesin e radios, harroi t, u kujtojë këtyre ndigjuesve se data 16 Nëntor është data, kur në Shkodër është hapur xhamia e pare në Shqipëri pas rënies së diktaturës komuniste. Nuk besojmë se kjo harresë mund të jetë e qëllimshme, sepse nuk besojmë që në Radio Tirana të këtë nëpunës që programojnë programe në këtë media dhe të jenë të shqetësuar se në Shqipëri janë hapur përsëri xhamiat për besimtarët muslimanë. Por, data që pasoi pas 16 nëntorit dhe që lidhet me shkatërrimet e institusioneve fetare në Shqipëri në vitin 1967, nga Radio Tirana në Enciklopedinë e saj të rrallës, na bëri të mendojme shumë dhe na bëri të shqetësohemi edhe më shume, sepse spikeri i Radio Tiranës

foli për shkatërrimin e qindra kishave në Shqipëri. Foli për shkatërrimin e qindra manastireve në Shqipëri dhe nuk tha asnjë fjalë për shkatërrimin e qindra e qindrave xhamiave që u bënë rrafsh me token duke përfshirë edhe margaritarin e xhamiave shqiptare, Xhaminë Parrucës, në një kohe që shumë kisha i shpëtuan shkatërrimit duke u kthyr në objekte publike. Nuk besojnë se është një harresë e rrallës injorimi në një shkallë të tillë i persekutimit të muslimanëve dhe i veprave të kultit të tyre nga një media e tillë me një traditë kohore publike të gjatë. Ne po e trajtojmë në media këtë qëndrim të Radio Tiranës si një provokim publik kundër muslimanëve në Shqipëri duke i kujtuar kësaj medie se duhet të ketë nën kontroll më të kujdesshëm punonjësit e saj që e përdorin hapësirën mediatike të Radio Tiranës për të shfryrë urrejtje personale ose të linjave të caktuara politike kundër muslimanëve dhe fesë së tyre islame.

Vëshguesi ,Shkoder, me 25 nëntor 2007

## 110 VJET BURG PER USHTARIN AMERIKAN NE IRAK



110 vjet burg ka marrë nga gjykata ushtari i divizionit prestigjoz amerikan në Irak Spilman, sepse kishte marrë pjesë në përdhunimin dhe pastaj në vrasjen e një 14 vjeçareje në fshatin Mahmudije në jug të Irakut. Edhe dy ushtarë të tjerë janë dënuar me 90 dhe 100 vjet burg për këtë krim makabër. Gjykata e kishte cilësuar fajtor ushtarin në fjalë sepse kishte qenë pjesëmarrës në këtë agresion të tmerrshëm që kishte filluar me vrasjen e babait nënës dhe motrës 6 vjeçare të victims dhe që kishte vazhduar me përdhunimin e 14

vjeçares Janabi. Pasi i përdhunuan dhe i vranë pjesëtarët e familjes në Mahmudije, ushtarët amerikanë i dogjën kufomat për të fshehur gjurmët e krimit dhe pastaj u arratisën. Në seancën e gjyqit ushtarë të tjerë amerikanë kanë dëshmuar në favor të të akuzuarve duke deklaruar se situata e luftë ka ndikuar në gjendjen e tyre mendore

Kjo ngjarje konsiderohen si një nga më të zezat për ushtrinë amerikane që nga fillimi i luftës në Irak. Por dënimin me vdekje do ta marrë ushtari Steven Gren i cili është ai që i vrau pjesëtarët e familjes irakiane në Mahmudije. Sipas këtij kriminel të vrasës një njeri është ikur të shtypësh një milingonë. Ti vret një njeri dhe pastaj thua; 'Në rregull. . Hajde të shkojmë të hamë një picë tani'

Këto janë fjalë të ushtarit amerikan Steven Green dhënë një gazetari duke na bërë të habitemi se deri ku mund të arrijë krimi aty ku flitet për luftë kundër terrorizmit

## - Pyetje -

### A nuk është e vërtetë se Islami është përhapur me shpatë?

#### Përgjigje:

Jo. Kjo nuk është e vërtetë. Megjithatë, në mendjet e shumë njerëzve ka një keqkuptim të dukshëm. Në Kur'an thuhet:

"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota" (Kur'an 2:256).

Ky varg i Kur'anit tregon se Zoti ka bërë që e vërteta dhe gënjeshtria të dallohen qartë nga njera-tjetra dhe për këtë arsye njerëzit janë të lirë të zgjedhin njërin ose tjetrën. Askush nuk mund të detyrojë njeri të besojë në fe sepse besimi është diçka shumë vetjake, personale. Ai që ndjek mësimet e Kur'anit nuk duhet të përpiqet t'ua imponojë atë të tjerëve.

Edhe Profeti Muhamed a.s. kurrë nuk kërkonte të bënte ndokënd musliman me forcë. Ja se çfarë i kishte shpallur Ai atij:

"Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? Nuk është e mundur për asnjë njeri të besojë (ndryshe), pos me ndihmën e Allahut" (Kur'an 10:99-100).

Nga kjo urdhëresë e Zotit bëhet e qartë se kushdo që mendon se mund të detyrojë të tjerët të besojnë, e ka gabim. Po të dëshironte Zoti, Ai mund t'i bënte të gjithë njerëzit besimtarë, por Ai parapëlqeu që këtë t'ia lërë vullnetit të tyre të lirë. Kështu që, askush nuk mund të detyrohet të besojë me forcë. Besimi është dhuratë e Zotit ndaj njeriut. A ka udhëzim e mesim më të mirë se ky? Si mundet një besimtar e ndjekës i vërtetë i Kur'anit t'ia kthejë shpinën këtij udhëzimi e t'ua imponojë besimin të tjerëve?

Përkundrazi, ja se si udhëzon Kur'ani ndjekësit e tij që t'u bëjnë thirrje njerëzve për te besimi i vërtetë:

"Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët me atë mënyrë që është më e mira" (Kur'an 16:125).

Ku thotë Kur'ani që t'u bëhet thirrje njerëzve me shpatë te koka? Askund. Zoti e udhëzonte të Dërguarin e Tij a.s. me këto fjalë:

"Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje" (Kur'an 12:108).

Edhe këtu, vihet në dukje që thirrja për në Islam të bëhet me dije të sigurt, me prova të qarta. Duke i pasur parasysh të gjitha këto, për çdo musliman është e kuptueshme se ai duhet ta paraqesë Islamin me prova të qarta (d.m.th., me njohje të sigurt) dhe t'i përdorë ato me urtësi e me ton këshillues e me dashamirësi duke arsyetuar me njerëzit që t'i pranojnë provat në mbështetje të besimit. Ç'hyn shpata këtu?

Në Enciklopedinë Junior të Kanadasë lexojmë:

"Islami është feja që po përhapet më me shpejtësi në gjithë botën" (The Junior Encyclopedia of Canada, 1990, Vëll. 2, f.396).

Këtu të lind pyetja: Kush po detyron sot ndokënd të bëhet musliman? Bile, muslimanët as që janë të angazhuar në mënyrë pak a shumë aktive në fushën e predikimit. Njerëzit po e përqafojnë Islamin me vullnetin e tyre të lirë sepse atë ua pranon arsyeja dhe logjika.

Huston Smith në librin e tij Fetë e Botës dhe pikërisht në faqen 256, na tregon se Profeti Muhamed a.s. u siguronte lirinë e besimit çifutëve dhe të krishterëve nën qeverisjen e muslimanëve. Profeti kishte hartuar një dokument të tillë ku thuhet se çifutët dhe të krishterët duhet të "mbrohen nga çdo fyerje dhe ngacmim; ata kanë të drejtë njësoj si populli ynë që të gëzojnë ndihmën tonë dhe trajtim të barabartë", dhe më tej, ata "do ta praktikojnë fenë e tyre lirisht sikurse muslimanët". Smith vë në dukje se muslimanët e konsiderojnë këtë dokument si "Karta e parë e lirisë së ndërgjegjes në historinë e njerëzimit dhe një model që duhet të ndiqet nga çdo shtet musliman në të ardhmen" (f.256).

Atëherë, a është përhapur Islami me anë të shpatës? Ja si përgjigjet në mënyrë të përmbledhur Ira Zepp, i cili nuk është musliman, në librin e tij të cituar më lart:

"Është fatkeqësi që Islami ka qenë portretizuar si 'fe e shpatës' ose se Islami është përhapur me anë të shpatës'. E vërteta historike pohon se Islami zakonisht është përhapur me bindje dhe jo me anë të fuqisë ushtarake. Sido që të jetë, Islami nuk mund t'i detyrohet askujt; në qoftë se, ta zëmë, dikush detyrohet me forcë ta shqiptojë shehadetin (d.m.th. deklaratën e pranimit të Islamit), kjo s'ka të bëjë fare me Islamin e vërtetë" (Mësime fillestare për muslimanin, nga Ira Zepp, Jr., 1992, Wakefield Editions, US, f.134).

Shabir Ali

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ  
BISMIL-LAHIRR-RRAHMANIRR-RRAHIME

Tregtojme  
**MISH HALLALL**

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**Produkte Hallall**

**KLIENTË TË NDERUAR!  
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,  
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:  
sallam, suxhuk etj.**

**2- Piceri hallall**

**3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni  
por hallalli i vërtetë është vetëm  
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MICJENI"  
Cel: 0692101893

EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT  
TE DRURIT

## ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bami-rës Islam), ju afro-n prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

Prodhim dyer e dritare

Dhoma gjumi

Pajisje zy-rash

Pajisje kuzhine

Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale-sh

Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas.

Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobil-it: 0692523565

